

VENDIM
Nr. 179, datë 20.11.2019

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ALBPETROL” SHA, NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË GAZIT NATYROR
(SHITJE ME PAKICË)

Në mbështetje të nenit 4, pika 11, 12 dhe 50; nenit 22, pika 2, germa “c”; nenit 75, pika 1, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “c”; nenit 5; nenit 8, nenit 9, pika 1, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 2, germa “e”; dhe nenit 10, pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.11.2019, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ALBPETROL” sh.a., dhe relacionin me nr. 102/8 prot., datë 12.11.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes për “Mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘ALBPETROL’ sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë)”.

konstatoi se:

- Shoqëria “ALBPETROL” sh.a., me shkresën e saj nr. 9605 prot., datë 25.10.2019, protokolluar në ERE me numrin 683 prot., datë 30.10.2019, ka paraqitur në ERE aplikimin për fillimin e procedurës për pajisjen me licencë “Furnizimi i gazit natyror (shitje me pakicë)”.

- Shoqëria “ALBPETROL” sh.a., nuk ka depozituar në ERE asnjë dokument sipas parashikimeve të nenit 8 dhe 9, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017.

- Shoqëria ka depozituar në ERE vetëm kërkesën për licencim, por pa e shoqëruar atë me dokumentacionin e nevojshëm e të mjaftueshëm për të legjitimuar shqyrtimin e kërkesës, në kuptim të parashikimeve të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.

- Nuk rezulton që nga ana e shoqërisë “ALBPETROL” sh.a., të jetë kryer pagesa e aplikimit, sipas parashikimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ALBPETROL” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë).

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti